



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 19.06.2020, Nr. 09-MM-21049



Në vështtrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, nr. 10/2018 të dt. 13/07/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Drejtori i Drejtoratit për Arsim, shpallë këtë:

K O N K U R S

- 1. SHFMU „Abedin Bujupi ” në Arllat.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, për vitin shkollor 2020/2021.
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 2. SHFMU „ Migjeni ” në Baicë.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, më kohë të pacaktuar.
- 3. SHFMU „ Jusuf Gërvalla ” në Negroc.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 4. SHFMU „Shotë Galica ” në Abri e Epërme.**
 - Dy mësimdhënës për arsim fillor, më kohë të pacaktuar.
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësi prej pezullimit.
- 5. SHFMU „Rasim Kijina ” në Drenas.**
 - Një mësimdhënës i Kimisë deri sa të kërket mësimdhënësi prej funksionit publik.
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 6. SHFMU „ Naim Frashëri ” në Gllobar.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, me kohë të pacaktuar.
- 7. SHFMU „ 24 Korriku ” në Fushticë e Poshtme.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 8. SHFMU „ Hasan Prishtina ” në Llapushnik.**
 - Një mësimdhënës për arsim fillor, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
 - Një edukatore, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 9. SHFMU „ Gani Elshani ” në Kroikovë.**
 - Një mësimdhënës i Matematikës me 20 orë (16 orë në SHFMU”Gani Elshani”-Kroikovë + 4 orë në SHFMU”Luigj Gurakuqi”-Sankoc), deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
 - Një mësimdhënës i Gjuhës Angleze me 18 orë, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 10. SHFMU „ Dëshmorët e Qendresës II ” në Tërstenikë.**
 - Një mësimdhënës i Gjuhës Angleze, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 11. SHFMU „ Halil Bajraktari ” në Drenas II.**
 - Një mësimdhënës i Gjuhës Angleze , deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
 - Një mësimdhënës i Edukatës Fizike më 10 orë , deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 12. SHFMU „ Xheladin Gashi-Plaku ” në Komaran.**
 - Një mësimdhënës i Gjuhës Angleze më 14 orë, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.
- 13. SHFMU „ M.S.Bytyqi ” në Arllat.**
 - Një Edukatore, me kohë të pacaktuar.
- 14. SHFMU „ Rilindja ” në Dobrashevc.**
 - Një mësimdhënëse mbështetëse, deri sa të kërket mësimdhënësja prej pushimit të lehonisë.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vëndet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.10 / 2018.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim.
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur më çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim, më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do të bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-s,të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit.

Dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentët e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurimit dhe dokumentet shtesë jashtë afatit të dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,

Më: 19.06.2020

